

**VENDIM**  
**Nr.111, datë 26.1.2011**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.486, DATË 25.7.2007 TË KËSHILLIT  
TË MINISTRAVE “PËR NDËRPRERJEN E VEPRIMTARISË SË PËRPUNIMIT  
TË ANIJEVE, QË TRANSFEROJNË NAFTË, GAZ DHE NËNPRODUKTE TË  
TYRE, NË PORTET E DURRËSIT DHE TË SHËNGJINIT”, TË NDRYSHUAR**

*(Ndryshuar me VKM nr. 226, datë 23.3.2016)*

*(i përditësuar)*

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 1 e 2 të ligjit nr.8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Në vendimin nr.486, datë 25.7.2007 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, togfjalëshi “të Shëngjinit”, kudo ku është përdorur, shfuqizohet.

2. Në portin e Shëngjinit të fillojë veprimtaria e përpunimit të anijeve, që trajtojnë produkte dhe nënprodukte të naftës, sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

3. *Trajtimi i produkteve dhe nënprodukteve të naftës, në këtë port, bëhet në anije dhe ato depozitohen në terminale, të cilat ndërtohen dhe përdoren në përputhje me legjislacionin në fuqi.*

4. *Shfuqizuar.*

5. *Terminalet depozituese të respektojnë kushtet e sigurisë së jashtme, të brendshme, normat për mbrojtjen e mjedisit, si dhe kushtet e normat teknike në fuqi.*

6. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Punëve Publike dhe Transportit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**